



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

Federata e Basketbollit
të Kosovës

+383 49 738 080
federata@basketbolli.com

Lagjia "Arbëria"
Blloku C3, Nr.83
Str: Radovan Zogovic
10 000 Prishtina

PROPOZICIONET E GARAVE TË KUPËS SË KOSOVËS 2025/26



Konform Nenit 24, pika 1.13. të Statutit të Federatës së Basketbollit të Kosovës, Bordi i FBK-së, në mbledhjen e mbajtur më 20.10.2025, miratoi:

PROPOZICIONET E GARAVE TË KUPËS SË KOSOVËS

2025/26

Neni 1 - Dispozitat e Përgjithshme

- 1.** Me këto Propozicione përcaktohen dispozitat mbi organizimin dhe zhvillimin e garave për Kupën e Kosovës dhe Kupat e Ligave 2025/26 (në tekstin e mëtejme - Garat për Kupë).
- 2.** Me këto dispozita përcaktohet sistemi i garave për Kupën, kalendari, shpenzimet e garave, mënyra e paraqitjes, tërheqja e shortit, ankesat dhe veprimet e tjera në lidhje me garat për Kupë.
- 3.** Federata e Basketbollit e Kosovës është organizatore e garave për Kupën e Kosovës dhe Kupën e Ligave në konkurrencën e meshkujve dhe të femrave.
- 4.** Me gara udhëheq Komisioni i Garave. Dënimet shqiptohen sipas Propozicioneve të Garave.
- 5.** Ekipëve fituese të finales së Kupës iu ndahen kupat dhe medaljet.
- 6.** Garat për Kupën e Kosovës udhëhiqen në bazë të dispozitave të këtyre Propozicioneve të Garave për Kupën e Kosovës, Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore dhe me Rregulloret e tjera të FBK-së.

Neni 2 - Ekipet Pjesëmarrëse

- 1.** Në garat për Kupë në mënyrë obligative marrin pjesë ekipet që bëjnë gara në:
 - a.** Superliga Meshkujt;
 - b.** Superliga Femrat;
 - c.** Liga e Parë Meshkujt;
 - d.** Liga Zhvillimore U21 Vajzat;
 - e.** Liga e Dytë Meshkujt.



Neni 3 - Tërheqja e Shortit

Paraqitja e ekipeve dhe tërheqja e shortit bëhet më së paku 7 ditë para fillimit të garave, fillimin e të cilave e cakton Komisioni i Garave dhe e verifikon Bordi i FBK-së.

Neni 4 - E Drejta e Paraqitjes

1. Të drejtën e paraqitjes në ndeshjet në garat për Kupën e Kosovës dhe Kupën e Ligave e gëzojnë të gjithë lojtarët-lojtaret e regjistruar-a në bazë të Rregullores për Regjistrim dhe Kalim në FBK.
2. Lojtari/ja i cili regjistrohet në afatin e rregullt kalimtar veror apo mini-afatin dimëror ka të drejtë paraqitje pa marr parasysh se a ka zhvilluar ndeshje për ndonjë ekip tjetër gjatë edicionit të Kupës së Kosovës 2025/26.
3. Nëse për ndonjërin ekip paraqitet lojtari-ja, që më parë nuk është regjistruar, ekipi i tij e humb ndeshjen me rezultat zyrtar 20:0.

Neni 5 - Sistemi i Garave: Kupa e Kosovës Femrat dhe Kupat e Ligave (Liga Zhvillimore U21 Vajzat, Liga e Parë Meshkujt dhe Liga e Dytë Meshkujt)

1. Garat për Kupën e Kosovës Femrat dhe Kupat e Ligave zhvillohen në sistem të eliminimit. Të gjitha ndeshjet zhvillohen sipas rregullave ndërkombëtare të lojës së basketbollit.
2. Ekipet e Superliga Femrat garojnë për Kupë të Kosovës Femrat (faza përfundimtare), garë e cila zhvillohet në formë të turneut Final 4 dhe zhvillohen ndeshjet gjysmëfinale dhe finale.
 - a. Skuadrat e Superligës së Femrave takohen sipas sistemit të Bergerit, në bazë të renditjes tabelare pas pesë xhirove të para.
 - b. Në ndeshjet çerek-finale ndeshen ekipet 3-6 dhe 4-5. Ndërsa ekipet 1 dhe 2 inkuadrohen prej gjysmë-finaleve.
 - c. Në gjysmë-finale ndeshen ekipi 1 me fituesin e ndeshjes 4-5; dhe ekipi 2 me fituesin e ndeshjes 3-6.
 - d. Në finale takohen fituesit e gjysmë-finaleve, ku ekipi i cili është fitues i parë i gjysmë-finaleve është vendas në ndeshjen finale.



3. Në xhiron e I dhe të II takohen të gjitha ekipet e Ligës së Parë (meshkujt), Ligës Zhvillimore U21 Vajzat dhe Ligës së Dytë (meshkujt), ku ndaras zhvillojnë ndeshjet për Kupën e Ligës përkatëse. Çiftet dhe ekipet që do të zhvillojnë ndeshjet si vendas caktohen në bazë të renditjes tabelare në momentin e tërheqjes së shortit (pa marrë parasysh ndonjë ndeshje të mbetur apo të shtyrë).

Neni 6 - Sistemi i garave: Kupa e Kosovës Meshkujt

1. Gara për Kupën e Kosovës Meshkujt zhvillohet me sistem vajtje-ardhje në fazën e çerekfinaleve dhe gjysmëfinaleve, ndërsa finalja zhvillohet me një ndeshje të vetme.

Çerekfinalet:

2. Pjesëmarrja dhe përballjet e ekipeve në fazën e çerek-finaleve përcaktohen me short të hapur, i cili organizohet nga FBK pas përfundimit të shtatë (7) xhirove të para të kampionatit ose jo më vonë se shtatë (7) ditë para fillimit të garave të Kupës së Kosovës. Ekipet përballen sipas çifteve të përcaktuara nga shorti, ku për çdo ndeshje veprohet në këtë mënyrë:

- a.** Tërhiqet ekipi i parë - ky do të jetë vendas në ndeshjen e parë.
- b.** Tërhiqet ekipi i dytë - ky do të jetë mysafir në ndeshjen e parë dhe vendas në ndeshjen e kthimit.
- c.** Ky proces përsëritet për të formuar të gjitha çiftet e ndeshjeve 1 deri 4.
- d.** Nga dy ndeshjet e zhvilluara për çdo çift, ekipi me diferencën më të madhe të pikëve (kosh-dallim) kualifikohet në gjysmëfinale.

Gjysmëfinalet:

3. Në fazën gjysmëfinale, takohen fituesi i Ndeshjes 1 me fituesin e Ndeshjes 4, si dhe fituesi i Ndeshjes 2 me fituesin e Ndeshjes 3.

- a.** Ekipet nga ndeshjet 1 dhe 2 i zhvillojnë ndeshjet e para si vendas, ndërsa ekipet nga ndeshjet 3 dhe 4 do jenë vendas në ndeshjet e kthimit.
- b.** Ekipi që, nga dy ndeshjet e zhvilluara, arrin rezultat më të mirë në kosh-dallim, kualifikohet në finalen e Kupës së Kosovës.



4. Finalja e Kupës së Kosovës zhvillohet si ndeshje e vetme, në një vend dhe kohë të përcaktuar me vendim të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK).

Neni 7 - Koha dhe vendi i zhvillimit të ndeshjeve

Për kohën dhe vendin e zhvillimit të ndeshjes vendasit janë të obliguar të lajmërojnë Komesarin e Garave, ekipin mysafir, vëzhguesin, gjyqtarët së paku 48 orë para zhvillimit të ndeshjes.

Neni 8 - Shpenzimet e personave zyrtarë

Shpenzimet e personave zyrtarë të ndeshjeve barten nga FBK.

Neni 9 - Vëzhguesit dhe Gjyqtarët

Detyrat e vëzhguesit dhe të gjyqtarëve janë të njëjta si në ndeshjet e kampionatit të rregullt.

Neni 10 - Ankesat

- 1.** Ankesat në ndeshje për garat në Kupë duhet të paralajmërohen më së voni 15 minuta pas përfundimit të ndeshjes. Arsyetimi i ankesës duhet ti dërgohet Komisionit të Garave më së largu 24 orë pas përfundimit të ndeshjes.
- 2.** Ankesës në ndeshjen e Kupës duhet t'i bashkëngjitet edhe dëshmia e mjeteve të paguara sipas Propozicioneve të Garave të FBK-së.
- 3.** Vëzhguesit janë të obliguar që në Raportin e ndeshjes të konstatojnë se është paraqitur ankesa.
- 4.** Vendimi mbi ankesën në shkallën e parë merret në afat prej njëzet e katër (24) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim.
- 5.** Në këtë vendim, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë, Komisioni i Ankesave dhe Arbitrazhit të FBK-së (KAA), në afat prej dymbëdhjetë (12) orëve, vendim i cili do të merret në afat prej njëzet e katër (24) orëve.
- 6.** Vendimi mbi ankesën në ndeshjen gjysmëfinale në shkallën e parë merret në afat prej katër (4) orëve dhe ju dorëzohet palëve me shkrim, pala e



pakënaqur ka të drejtë ankese në organin e shkallës së dytë-KAA, i cili vendimin do ta merret në afat prej tetë (8) orëve.

Neni 11 - Mos-paraqitja në ndeshje

Nëse ekipi nuk paraqitet fare në ndeshjet e garave të Kupës së Kosovës do të dënohet me minus katër (4) pikë në kampionatin e ligës përkatëse.

Neni 12 - Organizimi i Fazës Përfundimtare

1. Faza përfundimtare e Kupës së Kosovës Femrat zhvillohet në formë të turneut Final 4. Organizimin e fazës përfundimtare, Bordi i FBK-së mund t'ia besojë edhe ndonjërit prej klubeve apo agjencive të specializuara nën kushtet që do të parashtrojë paraprakisht Bordin dhe me përzgjedhësin do të lidhet Kontrata. Kushtet për fitimin e të drejtës së organizimit të Kupës i përcakton Bordin i FBK-së.

2. Organizimin e ndeshjes finale të Kupës së Kosovës Meshkujt, Bordin i FBK-së mund t'ia besojë edhe ndonjërit prej klubeve apo agjencive të specializuara nën kushtet që do të parashtrojë paraprakisht Bordin dhe me përzgjedhësin do të lidhet Kontrata. Kushtet për fitimin e të drejtës së organizimit të Kupës i përcakton Bordin i FBK-së.

Neni 13 - Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet të cilat nuk janë përfshirë në këto Propozicione, do të rregullohen sipas Propozicioneve të Garave për Kategoritë Seniore si dhe akteve tjera normative të FBK-së.

2. Interpretimin e këtyre Propozicioneve e bënë Bordin i FBK-së.

Miratuar në Prishtinë, më 20.10.2025

Arben **FETAHU**

Kryetar

Federata e Basketbollit të Kosovës

